



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM

PËR

SHPLLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR KOMANDIM NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 400, datë 07.10.2020, ka vendosur:

- *Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim.

Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur, është 2 (dy) vjet.

Komandimi mund të përsëritet edhe për një kohëzgjatje tjetër deri në 3 (tre) vjet.

Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

Kriteret (Kushtet) e komandimit janë:

- a) Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar ;
- b) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

- c) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- d) Kandidati të mos jetë i komanduar;
- e) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
 - i) të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - ii) të mos ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- f) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Kriteret (Kushtet) e komandimit do të verifikohen sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kriteret preferenciale të komandimit janë:

- a) Ekspertiza e veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;
- b) Njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor;
- c) Qenia autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
- d) Njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- e) Aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Kriteret preferenciale të komandimit do të vlerësohen sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në momentin e kandidimit, kandidati duhet të dorëzojë:

- a) Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim për pozicionin ku do të komandohet;
- b) Jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;
- c) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;
- d) Pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, etj;
- e) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Afati i paraqitjes së kërkesës për komandim me dokumentacionin shoqërues është 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të sipërcituar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Dokumentacioni i kandidimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimin nr.400, datë 07.10.2020, “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Ky njoftim është publikuar më datë 07.10.2020.